


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Nëntor 2020

**Tiranë, më 17 Dhjetor 2020:** Në Nëntor 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën 27 mld lekë, duke u rritur me 10,5 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 1,7 %, në krahasim me Tetor 2020. Importet e mallrave arritën vlerën 56 mld lekë, duke u rritur me 5,0 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u ulur 6,3 %, në krahasim me Tetor 2020. Deficiti tregtar i këtij muaji është 28 mld lekë, duke u rritur me 0,2 %, krahasuar me Nëntor 2019 dhe duke u ulur me 12,9 %, në krahasim me Tetor 2020.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%), Nëntor 2020



Në njëmbëdhjetëmujorin e 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën 249 mld lekë, duke u ulur me 10,1 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 544 mld lekë, duke u ulur me 8,4 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 295 mld lekë, duke u ulur me 6,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019.

### Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rritja vjetore e eksporteve prej 10,5 %, këtë muaj është ndikuar nga grupet: "Makineri, paisje, pjesë këmbimi" me +4,3 pikë përqindje, "Materiale ndërtimi dhe metale" me +3,5 pikë përqindje, "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me +2,4 pikë përqindje. Në uljen vjetore të eksporteve kanë ndikuar grupet: "Tekstile dhe këpucë" me -1,4 pikë përqindje, "Lëkurë dhe artikuj prej tyre" me -0,3 pikë përqindje, "Produkte kimike dhe plastike" me -0,1 pikë përqindje.

**Për publikim 17/12/2020**

**Fig. 2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Nëntor 2020**




Eksportet, gjatë këtij njëmbëdhjetëmujori janë ulur me -10,1 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Tekstile dhe këpucë” me -5,8 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,2 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,8 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Ushqim, pije, duhan” me +1,2 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +0,3 pikë përqindje.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Rritja vjetore e importeve prej 5,0 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +2,4 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +2,0 pikë përqindje. Në uljen vjetore të importeve kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -2,9 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -07 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me -0,6 pikë përqindje.

**Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Nëntor 2020**



Si njëmbëdhjetë mujor, importet janë ulur me 8,4 %, krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin e 2019. Grupet që kanë ndikuar në uljen vjetore të importeve janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,9 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -2,0 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -1,1 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Ushqim, pije, duhan” me +0,2 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me +0,1 pikë përqindje.

**Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**

Në muajin Nëntor 2020, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Nëntor 2019 janë: Italia (0,2 %), Kosova (16,7 %) dhe Greqia (32,4 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Spanja (35,5 %), Hungaria (45,2 %) dhe Suedia (48,5 %).

Gjatë këtij njëmbëdhjetëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë janë: Gjermania (14,6 %), Greqia (3,1 %) dhe Maqedonia e Veriut (1,9 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (15,0 %), Kosova (14,7 %) dhe Spanja (25,5 %).

Në muajin Nëntor 2020, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Nëntor 2019 janë: Italia (9,1 %), Kina (10,7 %) dhe Greqia (29,6 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Turqia (16,0 %), Gjermania (4,3 %) dhe Franca (15,6 %).

Gjatë këtij njëmbëdhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë janë: Gjermania (0,3 %), Serbia (36,9 %) dhe Rusia (20,1 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (9,7 %), Turqia (5,9 %) dhe Greqia (3,1 %).

**Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Nëntor 2020**



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 64,2 %, të gjithë tregtisë. Në Nëntor 2020, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,4 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 58,6 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (32,6 %), Greqia (7,6 %), Kina (7,4 %) dhe Turqia (6,7 %).

Shkëmbimet tregtare, për njëmbëdhjetëmujorin e 2020, me vendet e BE-së zënë 63,3 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Nëntor 2020, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 57,9 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (31,5 %), Greqia (7,7 %), Gjermania (7,2 %) dhe Turqia (6,8%).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mldlekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mldlekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mldlekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03 - 18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	04 - 18	27	11,3	53	5,2	-26	50,9
	05 - 18	30	24,3	57	2,1	-27	53,1
	06 - 18	27	18,1	54	-4,6	-28	49,2
	07 - 18	27	8,2	58	6,0	-31	46,0
	08 - 18	20	10,8	48	-2,3	-28	42,4
	09 - 18	26	8,9	51	-4,4	-25	51,4
	10 - 18	30	21,3	58	1,2	-28	51,7
	11 - 18	27	7,0	56	2,7	-29	48,4
	Janar –Nëntor 18	289	15,1	581	2,8	-293	49,7
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	04 - 19	27	0,1	57	8,9	-30	46,7
	05 - 19	28	-8,0	59	4,0	-31	47,0
	06 - 19	26	-4,1	53	-1,4	-28	47,9
	07 - 19	28	3,7	60	2,7	-32	46,4
	08 - 19	20	-1,8	52	7,1	-32	38,8
	09 - 19	25	-4,9	52	2,3	-27	47,8
	10 - 19	27	-10,2	59	1,8	-32	45,6
	11 - 19	25	-9,0	53	-5,6	-28	46,7
	Janar –Nëntor 19	277	-4,1	594	2,1	-317	46,6
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	03 - 20	18	-36,0	44	-20,8	-27	40,1
	04 - 20	15	-44,2	36	-36,4	-21	41,0
	05 - 20	22	-22,5	45	-24,2	-23	48,1
	06 - 20	23	-9,6	52	-2,4	-29	44,3
	07 - 20	25	-11,5	57	-5,0	-32	43,3
	08 - 20	19	-3,4	48	-6,7	-29	40,2
	09 - 20	25	1,3	52	0,5	-27	48,2
	10 - 20	27	-0,5	59	0,1	-32	45,3
	11 - 20	27	10,5	56	5,0	-28	49,1
	Janar –Nëntor 20	249	-10,1	544	-8,4	-295	45,8

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Nëntor 2019	Nëntor 2020	Jan. - Nën. 2019	Jan. - Nën. 2020	Nëntor 2019	Nëntor 2020	Jan. - Nën. 2019	Jan. - Nën. 2020
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>19.323</b>	<b>20.625</b>	<b>211.321</b>	<b>187.258</b>	<b>30.949</b>	<b>32.612</b>	<b>342.286</b>	<b>314.780</b>
Austri	134	211	1.683	1.510	544	444	6.300	5.220
Gjermani	1.199	1.407	13.186	15.106	4.248	4.065	41.756	41.891
Greqi	1.126	1.490	11.772	12.133	3.744	4.851	50.417	48.874
Itali	11.822	11.842	133.709	113.659	13.942	15.212	151.088	136.365
Spanjë	2.528	1.630	20.590	15.346	926	865	10.322	8.917
Kroaci	105	295	1.028	1.664	693	406	6.440	5.692
Tëtjër të BE-së	2.410	3.751	29.352	27.840	6.851	6.769	75.963	67.822
Mbretëri e Bashkuar	65	36	678	699	422	429	5.096	4.605
Kinë	523	531	5.864	4.390	5.092	5.639	54.468	48.725
Kosovë	2.287	2.669	27.607	23.563	509	741	7.133	7.442
Maqedonia e Veriut	776	889	7.838	7.991	716	796	7.835	8.143
Rusi	-	0	75	13	575	937	10.488	12.600
SHBA	222	299	3.413	2.908	649	791	11.140	8.288
Turqi	170	302	1.916	2.447	6.226	5.229	54.831	51.621
Ukrainë	29	13	157	356	185	314	2.749	3.756
Zvicër	64	19	844	619	1.514	561	14.395	9.252
Tëtjera	1.287	1.956	17.178	18.597	6.139	7.584	83.173	74.555
<b>Gjithsej</b>	<b>24.744</b>	<b>27.340</b>	<b>276.889</b>	<b>248.841</b>	<b>52.977</b>	<b>55.633</b>	<b>593.594</b>	<b>543.767</b>

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Nëntor 2019	Nëntor 2020	Jan. - Nën. 2019	Jan. - Nën. 2020	Nëntor 2019	Nëntor 2020	Jan. - Nën. 2019	Jan. - Nën. 2020
<b>Gjithsej</b>	<b>24.744</b>	<b>27.340</b>	<b>276.889</b>	<b>248.841</b>	<b>52.977</b>	<b>55.633</b>	<b>593.594</b>	<b>543.767</b>
Ushqime.pije.duhan	3.422	3.872	32.498	35.794	8.340	9.413	100.100	101.055
Minerale.lëndë djegëse.en.el.	4.167	4.771	45.583	36.600	5.940	4.391	71.108	47.895
Produkte kimike dhe plastike	629	613	7.173	6.822	7.115	7.983	80.937	81.557
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	230	145	2.283	1.691	1.477	1.148	16.081	11.670
Prodhime druri dhe letre	896	944	8.854	7.898	2.482	2.111	23.927	21.654
Tekstile dhe këpucë	9.654	9.313	110.309	94.375	7.906	7.710	80.302	68.305
Materiale ndërtimi dhe metale	3.314	4.175	42.122	37.157	5.603	6.871	72.977	71.059
Makineri.pajisje dhe pj. këmb.	1.682	2.739	19.767	20.651	11.839	13.316	125.455	118.992
Të tjera	749	768	8.302	7.852	2.276	2.692	22.708	21.579

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)**

	Itali		Kosovë		Spanjë		Gjermani	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
<b>Gjithsej</b>	<b>133.709</b>	<b>113.659</b>	<b>27.607</b>	<b>23.563</b>	<b>20.590</b>	<b>15.346</b>	<b>13.186</b>	<b>15.106</b>
Ushqim.pije, duhan	7.943	8.845	3.288	3.577	1.189	1.237	1.579	1.705
Minerale. Lëndë djegëse. Energji elektrike	4.867	1.121	6.489	4.501	16.835	12.760	829	1.361
Produkte kimik edhe plastike	1.910	1.856	2.009	2.014	49	102	68	57
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.922	1.479	5	9	204	71	12	29
Prodhime druri dhe letre	5.906	4.846	820	701	4	3	166	330
Tekstile dhe këpucë	85.741	71.004	107	131	2.102	998	7.019	8.132
Materiale ndërtimi dhe metale	12.569	11.646	12.599	10.541	195	124	1.352	1.043
Makineri.pajisje dhe pjesë këmbimi	9.362	9.546	687	693	8	29	1.422	1.790
Të tjera	3.489	3.316	1.603	1.396	5	22	739	658

**Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)**

	Itali		Turqi		Greqi		Kina	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
<b>Gjithsej</b>	<b>151.088</b>	<b>136.365</b>	<b>54.831</b>	<b>51.621</b>	<b>50.417</b>	<b>48.874</b>	<b>54.468</b>	<b>48.725</b>
Ushqim.pije, duhan	17.732	18.002	4.987	4.863	14.418	14.558	725	713
Minerale.lëndë djegëse.energjia elektrike	7.443	5.624	5.149	3.349	10.873	8.690	7	7
Produkte kimike dhe plastike	16.971	17.416	7.404	7.674	7.029	7.164	5.142	5.082
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	12.770	9.460	249	279	28	32	712	512
Prodhime druri dhe letre	6.409	5.283	3.101	2.753	3.270	3.328	973	769
Tekstile dhe këpucë	37.807	30.209	16.416	14.574	3.381	3.420	10.756	9.189
Materiale ndërtimi dhe metale	17.429	16.301	9.561	8.686	7.586	7.612	8.520	5.790
Makineri.pajisje dhe pjesë këmbimi	29.545	29.420	6.064	7.214	2.444	2.648	22.325	21.727
Të tjera	4.982	4.649	1.901	2.230	1.388	1.423	5.308	4.936

# Metogologjia

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë. të vendosura nën regjimin doganor. në përpunimin pasiv ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues. pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues.pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri ne kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë. Gjermani. Francë. Itali. Luksemburg. Holandë.Danimarkë. Irlandë. Greqi. Spanjë. Portugali. Austri. Finlandë. Suedi. Qipro. Çeki. Estoni. Hungari. Letoni. Lituani. Maltë. Poloni. Sllovaki. Slloveni. Bullgari. Rumani. Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri